



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 45, datë 31.01.2024**

**PËR**

**TRANSFERIMIN E GJYQTARIT {...}, NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 42 dhe 44/2B të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar Vendimit nr. 6 datë 18.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi zgjedhjen për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel, të gjyqtarit z. {...} protokolluar me aktin nr. 6309/20 prot., datë 23.01.2024, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë ku është caktuar në mënyrë të përhershme.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**